



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/144


Datë: 04.05.2017

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 4 maj 2017, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Zhvillim Ekonomik Lokal.
2. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

KONCEPT DOKUMENTI PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL

Prishtinë, Korrik 2016

Përmbajtja

1. Hyrje.....	3
2. Përshkrimi dhe definimi i çështjes/problemit kryesor	3
3. Synimi dhe Objektivat	11
4. Opsionet.....	12
5. Përmbledhje e opsioneve	13
6. Analiza e opsioneve	13
7. Konsultimi	15
8. Krahasimi i opsioneve	15
9. Rekomandimi.....	15
10. Komunikimi	15
11. Anekset.....	15
<i>Aneksi 1</i>	15
<i>Aneksi 2</i>	17
<i>Aneksi 3</i>	18
<i>Aneksi 4</i>	19
<i>Aneks 5</i>	19
<i>Aneksi 6</i>	21
<i>Aneksi 7</i>	22
<i>Aneks 8</i>	23
<i>Aneks 9</i>	25
<i>Aneksi 10</i>	25
<i>Aneksi 11</i>	26

1. Hyrje

Hartimi i Koncept dokumentit për Zhvillim Ekonomik Lokal vlerësohet si një nga prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ky dokument është paraparë të hartohet bazuar në Planin e Veprimit 2015-2018 për Zbatimin e Programit të Qeverisë dhe listës së koncept dokumenteve për vitin 2016.

Gjithashtu, koncept dokumenti është i bazuar dhe ndërlidhet me një sërë dokumentesh strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si: Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026 (SVL), Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2016-2021 (SKZH), Programin Kombëtar për Reforma Ekonomike (PKRE) 2015 dhe Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2017-2019 (KASH).

Marrë parasysh orientimet strategjike zhvillimore, idesë drejtë një zhvillimi më të qëndrueshëm të ekonomisë së vendit, veçanërisht nivelit lokal, si dhe në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian, koncept dokumenti trajton aspektet e zhvillimit ekonomik lokal të orientuara në drejtim të partneritetit me të gjitha palët e interesit dhe të planifikuar në mënyrë strategjike me qëllim të mundësisë së rritjes së punësimit, uljes së nivelit të varfërisë dhe rritjen e cilësisë së jetesës nëpërmjet përmirësimit dhe avancimit të vetëqeverisjes lokale në fushën e ekonomisë.

Në këtë kontekst, duhet theksuar se hyrja në fuqi e MSA-së ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian ka mundësuar hapjen e rrugës së përfundimit të tranzicionit ekonomik dhe kalimit drejtë një ekonomie funksionale të tregut.

Për hartimin e këtij koncept dokumenti është nxjerr Vendim me datë 19 prill 2016 për themelimin e grupit punues ndërministror. Grupi punues ka përbërje të gjerë të përfaqësimit nga pothuajse të gjitha institucionet e vendit të cilat janë kompetente në një mënyrë apo tjetër në fushën e zhvillimit ekonomik lokal

2. Përshkrimi dhe definimi i çështjes /problemit kryesor

Në përputhje me nenin 17 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Komunitat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për sa i përket interesit lokal, ku në mënyrë të precizuar në pikën a) të këtij neni përcaktohet fusha e zhvillimit ekonomik lokal. Gjithashtu, në nenin 58, pika i) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, përgjegjësi e kryetarit të komunës është edhe propozimi i zhvillimit komunal. Duke ju referuar bazës ligjore të lartë cekur, lirisht mund të themi se për të pasur zhvillim ekonomik të qëndrueshëm në Kosovë, patjetër se duhet të ketë zhvillim ekonomik lokal. Në këtë kontekst, ndërtimi i politikave në nivelin lokal është parakusht kryesor për mirëqenien e përgjithshme të qytetarëve. Marrë në përgjithësi, pothuajse të gjitha

komunat posedojnë strategji për zhvillim ekonomik lokal bazuar në prioritetet e vëna nga secila komunë veç e veç. Prandaj, duke e ditur rëndësinë e kësaj fushe, Komunat janë duke bërë përpjekje që përmes zhvillimit ekonomik lokal të përmirësojnë dhe ngritin kualitetin e jetës së qytetarëve duke krijuar mundësi të reja në mirëqenien ekonomike dhe shoqërore. Për të arritur këto qëllime, komunat fokus të veçantë janë duke i dhënë përmirësimit dhe zhvillimit të infrastrukturës lokale, krijimit të kushteve të përshtatshme për zhvillimin, promovimin e bizneseve të vogla dhe të mesme lokale, nxitjen e krijimit të vendeve të reja punës përmes investimeve të reja qoftë nga vendi, e po ashtu edhe nga jashtë.


Komunat janë përgjegjëse për të krijuar një klimë dhe ambient të favorshëm të të bërit biznes me qëllim të zhvillimit ekonomik lokal. Për të pasur një zhvillim ekonomik lokal, patjetër se duhet të ketë një politikë gjithëpërfshirëse dhe të ndërtuar mirë në nivelin lokal, ku në të do të ndërtheheshin programe të ndryshme dhe të qarta, të cilat janë të ndara sipas fushave përkatëse, duke u nisur nga: investimi në resurset njerëzore, ruajtja dhe përparimi i bizneseve ekzistuese, tërheqja e bizneseve të reja, planifikimi dhe përcaktimi i zonave për investim, ofrimi i ambientit të sigurt dhe të përshtatshëm për investime direkte të huaja, adoptimin e teknologjive të moderuara, menaxhimin e resurseve dhe shfrytëzimin e tokës së pashfrytëzuar, si dhe shumë faktorë të tjerë të cilët ndikojnë dhe janë determinues në zhvillimin ekonomik lokal.

Në këtë drejtim, hartimi i politikave të qarta dhe konkrete, si dhe procesi i planifikimit strategjik për zhvillimin ekonomik lokal, do të mund të realizohet përmes kulturës së përbashkët të punës ndërmjet njerëzve dhe formimit të partneriteteve afatgjata. Po ashtu, këto elemente thelbësore do të mundësonin një rritje të qëndrueshme ekonomike, ku përfitimet ekonomike, përmirësimi i kushteve dhe i cilësisë së jetës së të gjithë qytetarëve, pa dallim, do të ishte crucial dhe i dukshëm.

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës përqendrohet në pesë shtylla kryesore; zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, punësimi dhe mirëqenia; sundimi i ligjit dhe shteti ligjor; agjenda evropiane dhe politika e jashtme; arsimit, shkenca, kultura, sporti dhe zhvillimi rinor; dhe shëndetësia moderne.¹

¹ Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015-2018

Struktura e BPV-së²



Normat e rritjes ekonomike gjatë viteve të fundit ishin mesatarisht 3.3% në vit, prej vitit 2009. Të ardhurat për kokë banori në Kosovë janë në nivel prej 11% në raport me vendet e Bashkimit Evropian dhe për të arritur këtë nivel të BE-së, Kosovës i duhet një normë e rritjes prej rreth 8% për 30 vitet e ardhshme.³

Krahasimi i pesë treguesve të përzgjedhur⁴

Krahasimi i pesë treguesve të përzgjedhur	Kosova	Mesatarja e vendeve të Evropës Juglindore që nuk janë anëtare të BE-së
Treguesi		
Bruto produkti vendor për kokë banori	€2.935	€3.504
Përqindja e papunësisë	30,1%	20,8%
Pjesëmarrja në tregun e punës	40,5%	49,7%
Përqindja e popullsisë që jetojnë në varfëri	29,9%	19,7%
Raporti mes eksporteve dhe importeve	12,0%	46,5%

Prandaj, në këtë fazë të re të zhvillimit, nevojitet një qasje e re ndaj politikave zhvillimore në nivel lokal. Kjo qasje e re duhet të adreson të gjithë faktorët që kufizojnë rritjen ekonomike.

² Korniza afatmesme e shpenzimeve 2017-2019

³ Strategjia kombetare për zhvillim 2016-2021

⁴ Strategjia kombetare për zhvillim 2016-2021

Komunat mund të hartojnë strategjitë për zhvillim socio ekonomik lokal, por disa nga to nuk janë në harmoni me KASH-in ose me prioritetet e qeverisë dhe shpesh herë e kanë të vështirë zbatimin e tyre për shkak të kufizimeve buxhetore. Gjendja aktuale e strategjive për zhvillim socio ekonomik lokal në komuna është si vijon: 21 komuna nuk kanë fare SZHEL, 3 komunave ju ka skaduar afati, 8 komuna i kanë strategjitë e tyre valide, 6 komuna janë në procedurë të hartimit të strategjive.

Koordinimi i nivelit qendror dhe nivelit lokal për planifikimin të investimeve, ngritje të kapaciteteve, shëndetin primar, arsimin para universitar, krijimin e kushteve më të favorshme të të bërit biznes, përkrahja e bizneseve familjare dhe zhvillimi i politikave të tjera sektoriale.

Përkrahja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme nëpërmjet politikave zhvillimore do të mundësonte joshjen e investimeve të bizneseve në nivel lokal, sidomos në sektorin e prodhimit dhe në sektorin e shërbimeve, do të ndikonin në shtimin e vlerës së tyre. Zhvillimi i politikave në nivel lokal do të rrisin kapacitetet prodhuese, gjenerimin e vendeve të punës, si dhe krijimi i politikave sektoriale që i bënë komunat të jenë vend i përzgjedhur për investime.

Në këtë drejtim, rritja e nivelit të Investimeve të Huaja Direkte (IHD) do të bëjë që ekonomia lokale t'i mbulojë nevojat e saj financiare dhe të krijojë kushte më të mira jetësore për komunitetin. Kjo nënkupton se një biznes i huaj duhet të gjejë mbështetje konkrete nga komunat me qëllim të investimit në nivelin lokal.

Adresimi i informatave nga niveli qendror në nivelin lokal në lidhje me legjislacion primar dhe sekondar, si dhe me marrëveshje të tjera bashkëpunimi lidhur me mundësinë e investimeve të huaja, do tu lehtësonte investitorëve të huaj qasje më të lehtë, si dhe krijimin e kushteve më të favorshme për investime në komuna.

KOMUNITETI I BIZNESIT

Ndërmarrjet aktive në Kosovë sipas numrit të punëtorëve në vitin 2015 (të verifikohet thirrja)

Klasifikimi sipas madhësisë së ndërmarrjes	Numri i punëtorëve	Numri i ndërmarrjeve	Pjesëmarrja në total
Mikro	1--9	37,420	94.1
Të vogla	10--49	1,998	5.0
Të mesme	50--249	305	0.8
Të mëdha	250 e më shumë	49	0.1
Gjithsej		39,772	100.0

Ndërmarrjet aktive në Kosovë sipas llojit të pronësisë në vitin 2015

NR	Lloji i pronësisë	Numri i ndërmarrjeve	Pjesëmarrja në
----	-------------------	----------------------	----------------

		total
1	Biznes individual	30,899
2	Ortakëri e përgjithshme	596
3	Ortakëri e kufizuar	5
4	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar	7,842
5	Shoqëri aksionare	140
6	Ndërmarrje me pronësi të huaj	268
7	Ndërmarrje shoqërore	4
8	Ndërmarrje publike	1
9	Kooperativa bujqësore	13
10	Tjera- nën juridiksionin e AKP-se	4
	Gjithsej	39,772
		100.0

Zonat ekonomike në Kosovë

Parku i biznesit	Glllogovc
Parku i biznesit	Mitrovicë
Parku Industrial	Mitrovicë
Zonat ekonomike	Gjakovë
Zonat ekonomike	Prizren
Zona Agro - Industriale	Suharekë
Parku teknologjik	Shtime
Zona ekonomike	Lipjan

Burimet financiare të një komunë përbëhen nga: të hyrat vetanake të komunës, grandet qeveritare, grandet e donatorëve të jashtëm dhe huamarrja komunale.

Të hyrat vetanake komunale janë mjetet financiare që mblidhen nga taksat, tarifat, gjobat, pagesat për shërbimet publike të ofruara nga komuna, qiratë nga pronat e paluajtshme në pronësi të komunës, të hyrat nga shitja e pasurive komunale, ato nga ndërmarrjet komunale, bashkë pagesat nga shërbimet në arsim dhe shëndetësi, etj⁵.

Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale (KAB) është një dokument i cili rishikohet dhe miratohet çdo vit nga Kuvendi i Komunës. Ky dokument ofron një analizë të

⁵ (Ligji nr. 03/l-049)

hollësishme të të hyrave dhe shpenzimeve të komunës. Shpenzimet duhet të planifikohen për të pasqyruar prioritetet strategjike për zhvillimin e vazhdueshëm të komunës. KAB siguron një mekanizëm të dobishëm përmes të cilit prioritetet e identifikuar në dokumentet strategjike të komunës mund të integrohen më mirë në procesin e buxhetit.

Komunat pranojnë Grante Operative nga Buxheti i Konsoliduar i Republikës së Kosovës. Grantet Operative janë: Grantet e Përgjithshme, Grantet Specifike për Arsim dhe Grantet Specifike për Shëndetësi.

Granti i përgjithshëm - Komunat pranojnë një Grant të Përgjithshëm të cilin mund ta shfrytëzojnë për ushtrimin e kompetencave të tyre komunale. Shuma e Grantit të Përgjithshëm është 10% e të hyrave totale të buxhetuara të qeverisë qendrore. Pjesa e mbetur e Grantit të Përgjithshëm ju alokohet komunave në përpjesëtim me: (89%); numri i popullsisë pakicë me tre përqind (3%); komunat, shumica e popullsisë së cilave përbëhet nga pakicat kombëtare me dy për qind (2%); dhe përmasat gjeografike me gjashtë për qind (6%). Përcaktimi i shumës së Grantit Specifik për Arsim dhe një Grantit Specifik për shëndetësi bazohet në një qasje të hapur të financimit.⁶

Trendet e Buxhetit komunal për periudhën 2010-2015 përformuan në planifikim një rritje mesatare prej 8.3%, ndërsa në shpenzimeve me një mesatare prej 8.4%. (shih aneksin 1 dhe 2)

Realizimi i buxhetit komunal në periudhën 2010-2015 është 90.0%, ku shikuar sipas kategorive ekonomike, kjo dallon sidomos tek realizimi i investimeve kapitale e cila është 78%, ndërsa kategoria e pagave dhe mëditjeve është realizuar 99%, pastaj mallrat dhe shërbime 90%, shpenzimet komunale 93% dhe subvencionet dhe transferet 91%.

Pra duke pasur parasysh gjendjen aktuale dhe nevojën e madhe për me shume investime shihet se kategoria e investime është realizuar në nivel jo të kënaqshëm prej 78%.

Investimet kapitale në komuna sipas sektorëve për periudhën 2013-2015 - Mesatarja e realizimit të investimeve kapitale në komuna është realizuar 78.7%, ku shikuar sipas sektorëve në sektorin e rrugëve mesatarja e realizimit është 84.0% në sektorin e kanalizimit 88.0%, pastaj në sektorin e ujësjellësit 75.0% , në ndërtim dhe rregullim të objekteve 72.2%, në arsim 76.5%, në shëndetësi 77.7% në kulture rini dhe sport 61.7%, në ambient 72.7%, në shërbime publike 80.9%, në infrastrukturë 73.5% (shih aneksin 5)

⁶ (Ligji nr. 03/1-049)

Trendet e investimet kapitale në komuna sipas sektorëve për periudhën 2013-2015 I shprekur ne %											
Nr	Sektori	Krahasimet 2013-2015							mesatarja e realizimit	Mesatraja e pjesmarrjes sipas sektoreve në buxhet	Mesatraja e pjesmarrjes sipas sektoreve në shpenzimet
		Nr i projekteve 2014-2013	Nr i projekteve 2015-2014	mesatarja e projekteve	Buxheti 2014/2013 (%)	Buxheti 2015/2014 (%)	Shpenzimet 2014/2013 (%)	Shpenzimet 2015/2014 (%)			
1	Rrugë	-156	87	777	-4.7	9.8	-14.6	23.2	84.0	34.8	37.2
2	Kanalizim	-64	44	193	-9.1	7.4	-12.4	8.1	88.0	5.5	6.2
3	Ujësjellës	-12	-6	86	-31.0	22.2	-37.6	-9.9	75.0	3.6	3.4
4	Ndërtimi dhe rregullimi i objekteve	-28	28	76	-16.8	-10.9	-21.7	-24.3	72.2	3.2	3.0
5	Arsim	-16	65	240	-31.0	10.3	-33.6	3.2	76.5	9.8	9.6
6	Shëndetësi	-16	-5	112	10.0	-14.9	21.0	-12.5	77.7	3.5	3.5
7	Kulturë, rini dhe sport	-31	33	151	-2.3	-1.0	-2.5	-18.1	61.7	4.5	3.5
8	Ambient	-13	3	91	-25.0	59.0	-49.5	104.7	72.7	3.3	3.1
9	Sherbime publike	7	69	181	-2.8	57.2	-3.7	29.7	80.9	5.6	5.7
10	Infrastruktura	36	-25	149	25.8	-39.3	20.5	-49.9	73.5	7.7	7.3
11	Bujqësi	22	21	88	43.1	46.4	21.6	4.3	73.8	1.7	1.5
12	Turizmi	5	2	12	-9.1	6.7	-37.8	25.4	76.4	0.2	0.2
13	Të tjera	31	62	410	-29.4	36.3	-39.3	20.0	75.4	16.5	15.8
14	Totali	-235	378	2,565	-11.2	11.0	-18.8	8.4	78.7	100.0	100.0

Shikuar mesataren në nivelin e pjesëmarrjes së investimeve në buxhet dhe në shpenzime sipas sektorëve për periudhën 2013-2015 në sektorin e rrugëve nga totali i investimeve janë buxhetuar 34.8%, ndërsa janë realizuar 37.2%, në kanalizim janë buxhetuar 5.5% ndërsa janë realizuar 6.2%: në ujësjellës janë buxhetuar 3.6% ndërsa janë realizuar 3.4%; në ndërtim dhe rregullim i objekteve janë buxhetuar 3.2% ndërsa janë realizuar 3.0%; në arsim janë buxhetuar 9.8% dhe janë realizuar 9.6%; në shëndetësi janë buxhetuar 3.5% ndërsa janë realizuar 3.5%; në kulturë, rini dhe sport janë buxhetuar 4.5% ndërsa janë realizuar 3.5%; në ambient janë buxhetuar 3.3% ndërsa janë realizuar 3.1%; në shërbime publike janë buxhetuar 5.6% dhe janë realizuar 5.7%; në infrastrukturë janë buxhetuar 7.7% ndërsa janë realizuar 7.3%; në bujqësi janë buxhetuar 1.7% ndërsa janë realizuar 1.5%; në turizëm janë buxhetuar 0.2% dhe janë realizuar 0.2%; dhe të tjera janë janë buxhetuar 16.5% ndërsa janë realizuar 15.8%.

Për vitin 2016, janë parashikuar 2,256 projekte. Nga granditë e qeverisë vlera e financimit të këtyre projekteve është 57,696,011.00€, nga të hyrat vetanake parashihet të realizohen 62,842,247.00€, donatorët e brendshme do mbështesin projekte prej 1,033,403.00€, dhe donatorët e jashtëm prej 1,833,546.00€ (shih aneks nr.9)

Investimet e nivelit qendror në komuna - Historikisht komunat përkrahen nga ministritë e linjës për realizimin e projekteve sipas prioriteteve të tyre. Parashikimet e ministrive të linjës për periudhën 2013-2015 janë 156,843,141.00€ me 492 projekte, duke filluar nga Ministria e infrastrukturës e cila veçohet me 134 projekte në vlerë

prej 65,595,567.00€ dhe Ministria e punës dhe mirëqenie sociale me 1 projekt, në vlerë prej 1000,000.00€ (shih aneksin 6 dhe 7).⁷

Komunat e Republikës së Kosovës, përveç nga granti i qeverisë, financohen edhe nga të hyrat vetanake të mbledhura për ofrimin e shërbimeve komunale edhe pse me një pjesëmarrje mesatarisht të ulët, por që plotëson një pjesë të financimit të zhvillimit të aktiviteteve në kuadër të kompetencave të tyre. Të hyrat komunale ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik të komunave të Republikës së Kosovës.

Komunat e Republikës së Kosovës planifikojnë të hyrat vetanake në mënyrë që të vlerësojnë sasinë e të hyrave vetanake që do të kenë në dispozicion që t' i përdorin për të financuar shpenzimet e nevojshme. Për planifikimin real të të hyrave, komunat analizojnë faktorët ekonomik që ndikojnë në vëllimin e të hyrave dhe shqyrtojnë të gjitha mundësitë për rritjen e tyre të vazhdueshme. Pjesëmarrja e të hyrave vetanake në të hyrat e përgjithshme të qeverisë për periudhën 2010-2015 ka qenë mesatarisht 4.10%. (shih aneksin 10).

Ndërsa pjesëmarrja e të hyrave vetanake në të hyrat e përgjithshme komunale për periudhën 2010-2015 ka qenë mesatarisht 16.70%. (shih aneksin 11).

Tatimi në pronë është e hyrë kryesore e komunave e cila për periudhën 2010-2015 ka një rritje mesatare prej 7.23%, pastaj të hyrat nga lejet e ndërtimit rritje prej 2.31%, të hyrat nga ndërrimi i destinimit të tokës rritje prej 22.23% etj. Vlen të theksohet se të hyrat nga veprimtaria afariste nga viti në vit ka rënie prej (12.4%). (shih aneksin 8)

Është e rëndësishme që të hyrat e grumbulluara nga komunat të rikthehen tek qytetarët në formën më të mirë të mundshme të ofrimit të shërbimeve sa më të mira dhe më cilësore, pra të ju dëshmohet qytetarëve se menaxhimi i mjeteve të tyre financiare është transparent dhe që përdoret për shërbime afër tyre.

Problemet kryesore të komunave në fushën e zhvillimit ekonomik janë: varësia e madhe buxhetore e nivelit lokal nga grantet qeveritare në nivelin rreth 85%; një numër i madh i zonave ekonomike nuk janë funksionale; klime jo shume e favorshme në nivel lokal për joshjen e investimeve të huaja direkte, ku komunat nuk kanë informata të mjaftueshme për mundësit e këtyre investimeve; kufizimet në huamarrje komunale etj.

Adresimi i problemeve bëhet në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet nivelit qendror dhe nivelit lokal, duke zhvilluar politika sektoriale të cilat ndikojnë në zhvillim të qëndrueshëm ekonomik lokal si:

⁷ Te dhënat janë bazuar ne ligjet e buxhetit për vitet 2013-2015, nuk kemi informata nëse kane përfunduar te gjitha.

- Rishikimi i formulës së financimit të pushtetit lokal, zhvillimi i kriterëve për financim lokal, bartje e kompetencave nga niveli qendror në nivelin lokal në fushën e buxhetimit, krijimi i mundësive më të mëdha për rritjen e të hyrave vetanake me qëllim të uljes së varshmërisë buxhetore nga niveli qendror.
- Niveli qendror të krijoj kushte të nevojshëm me qëllim të funksionalizimit të zonave ekonomike me qëllim të balancimit të të gjitha komunave të cilat me fuqizimin e tyre do të ndikojnë në rritje ekonomike përmes udhëzimeve të ndryshme, fushatave për sensibilizim të bizneseve etj;
- Niveli lokal duhet të jetë me i informuar në lidhje me mundësit e investimeve të huaja dhe të trajtoj këtë çështje me prioritet në mënyrë që investorët të kenë adresë të qarta në lidhje me interesat e tyre;
- Të arrihet një përafrim i nivelit qendror dhe lokal në fushën e huamarrjes komunale përmes rishikimit të legjislacionit dhe rritjen e performances pozitive të komunave karshi opinioneve të auditimit.

3. Synimi dhe Objektivat

Synimi

Ky koncept dokument synon të trajtoj çështjet kryesore që ndërlidhen me hartimin politikave për zhvillim ekonomik lokal. Republika e Kosovës deri tani nuk ka pasur të hartuar ndonjë dokument politikash për zhvillimit ekonomik lokal. Në mungesë të këtyre politikave zhvillimore komunat vazhdojnë të trajtojnë këtë çështje në kuadër të KASH-it, planeve zhvillimore të komunave, ose edhe përmes strategjive për zhvillim socio- ekonomik lokal të cilat në shumicën e rasteve komunat kanë vështirësi në implementimin e tyre për shkak të vështirësive buxhetore apo mbështetja në burime të financimit jo të qëndrueshme. Politikat për zhvillim ekonomik lokal duhet të sigurojnë qëndrueshmëri të ekonomisë lokale, në mënyrë që të ndikojë në përmirësimin e jetës së qytetarëve në të gjitha fushat.

Objektivat

Në lidhje me këtë, koncepti dokumenti për zhvillim ekonomik lokal duhet të definojë objektivat që kryesisht lidhen me:

- Zvogëlimi i varësisë buxhetore të komunave nga niveli qendror përmes rishikimit të formulës së financimit dhe zhvillimi i kriterëve për financim lokal;

- Funkcionalizim i plotë i zonave ekonomike të balancuara me qëllim të përfitimit të të gjitha komunave dhe komunitetit të biznesit;
- Tërheqja e investimeve të huaja direkte përmes përmisimit të shërbimeve ndaj investitorëve të huaj (funktionalizimit të plotë të one stop shopeve) dhe krijimit të kushteve më të favorshme për investitorëve të huaj.
- Jetësimi i huamarrjes komunale përmes rritjes së performancës buxhetore komunale
- Rishikimi i Legjislacionit që ndikon në ZHEL
- Zhvillimi i Turizmit Lokal

4. Opsionet

Janë tri opsione të cilat i kemi në procesin e hartimit të Strategjisë për zhvillim ekonomik lokal:

Opsioni i parë, ruajtja e status quo-së (asnjë ndryshim);

Opsioni i dytë, nxjerrja e projektligjit për zhvillim ekonomik lokal;

Opsioni i tretë, hartimi i politikave për zhvillim ekonomik lokal (opsioni i rekomanduar).

Opsioni i parë

Ruajtja e status quo-së (asnjë ndryshim), ka këto efekte:

1. Ndikon në vazhdimësinë e varësisë së madhe buxhetore të komuna nga niveli qendror me afër 85%;
2. Ndikon në mos qasjen e investimeve të huaja direkte në nivelin lokal;
3. Ndikon në vazhdimin e vështirësive për huamarrje komunale;
4. Ndikon në vështirësitë e implementimit të planeve zhvillimore komunale;

Opsioni i dytë

Nxjerrja e projektligjit për zhvillim ekonomik lokal ka këto efekte:

1. Ndikon në harmonizimin e legjislacionit i cili e rregullon pjesërisht çështjen e zhvillimit ekonomik lokal e cila kërkon një kohë shumë të gjatë;
2. Ndikon në hartimin e legjislacionit sekondar të fushave të caktuara që ndikojnë në zhvillim ekonomik lokal;
3. Ndikon në trajtimin gjithëpërfshirës të investimeve kapitale në nivelin lokal;

Opsioni i tretë

Opsioni i rekomanduar ose hartimi i politikave për zhvillim ekonomik lokal ndërlidhet me pikat kryesore:

5. E para, rritja e nivelit të burimeve të financimit nga të hyrat vetanake do të ndikoj dukshëm në rritjen e investimeve kapitale e me te edhe mirëmbajtën e këtyre investimeve e cila kërkon një trajtim të veçantë dhe të vazhdueshëm.
6. E dyta, qëndrueshmëria financiare do të ndikojnë në ofrimin e shërbimeve me cilësore për qytetaret dhe komunitetin e biznesit.
7. E treta, krijimi i kushteve më të mira të punës, lehtësira në taksat komunale dhe mbështetje e vazhdueshme për komunitetin e bizneseve.
8. E katërta, zhvillimi i sektorit të turizmit, dhe bujqësisë do të përkrahte komunitetin për ndërmarrësi.

Është e rëndësishme të potencohet se opsioni i rekomanduar është hartimi i politikave për zhvillim ekonomik lokal e cila do të orientonte zhvillimin ekonomik lokal në rrugë konkrete dhe në një stabilitet zhvillimor.

9. Përmbledhje e opsioneve

Opsionet lidhur me zhvillimin ekonomik lokal mund të përmbledhen si në vijim:

- Ruajtja e status quo-së (asnjë ndryshim), pra do mbetet gjendja e njëjtë dhe zhvillimi ekonomik lokal do të ketë mjaft vështirësi për të arritur një qëndrueshmëri;
- Nxjerrja e projektligjit për zhvillim ekonomik lokal, nuk do të adresonte zhvillimi e të gjitha politikave sektoriale të cilat do te ndikonin ne zhvillim ekonomik lokal;
- Hartimi i politikave për zhvillim ekonomik lokal (opsioni i rekomanduar), do te ndikonte ne adresimin e te gjitha nevojave për zhvillim të qëndrueshme ekonomik lokal dhe do të epte orientime strategjike afatgjate.

10. Analiza e opsioneve

Opsioni i parë, Ruajtja e status quo-së do të thotë ruajtja e gjendjes ekzistuese dhe zhvillimi ekonomik lokal ka një jostabilitet qoftë financiar edhe në aspektin e përmirësimit të jetës së qytetarëve dhe komunitetit të biznesit. Opsioni i parë nuk ka kosto financiare shtesë, mirëpo nuk siguron përmirësim të gjendjes aktuale.

Opsioni i dytë, Nxjerrja e projektligjit për zhvillim ekonomik lokal nënkupton një qasje të rishikimit të të gjithë legjislacionit aktual në fuqi dhe një harmonizim me të gjithë legjislacioni aktual i cili aktualisht po pëson plotësim ndryshime të shpeshta,

por që mund të reflektoj në konsumimin e një kohe të gjatë dhe një angazhimi shumë të madh por që prapë nuk do të rregulloj të gjithë adresimin e nevojave për përmirësim të politikave ekzistuese. Megjithatë edhe opsioni i dytë nuk i përgjigjet në tërësi specifikave që ka zhvillimi ekonomik lokal. Opsioni i dytë ka kosto financiare shtesë.

Opsioni i tretë, hartimi i politikave për zhvillim ekonomik lokal trajton qëndrueshmërinë e zhvillimin e ekonomik lokal si një qasje e përmirësuar e gjendjes aktuale stabilitet financiar, pavarësi e komunave në ofrimin e mundësisë për trasim të rrugës në investime të huaja direkte, realizim të investimeve më të mëdha përmes huamarrjes komunale.

Bazuar në këtë opsion të rekomanduar komunat do të kenë një stabilitet ekonomik dhe rritje të cilësisë së shërbimeve ndaj qytetareve dhe komunitetit të biznesit. Është me rëndësi ti referohemi edhe shtyllës së parë të Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës e cila është zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, punësimi dhe mirëqenia. Gjithashtu planifikimi i qëndrueshëm strategjik në fushat sektoriale do të ndihmoj komunat në funksionimin dhe ushtrimin e kompetencave të veta. Opsioni i tretë ka kosto financiare shtesë.

Kosto financiare e përafërt e secilit opsion

PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT FINANCIAR					
(000 Euro)					
	Viti aktual	Viti 2	Viti 3	Viti 4	
<i>Opsioni 1</i>					
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Financimi i pritur nga donatorët	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
<i>Opsioni 2</i>					
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Financimi i pritur nga donatorët	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
<i>Opsioni 3</i>					
Diferenca neto në alokimin e shpenzimeve	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Diferenca neto në gjenerimin e të hyrave	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00
Financimi i pritur nga donatorët	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00

11.Konsultimi

Konsultimet do të bëhen me shumë akterë si: Komunat, Kolegjiunet e ndryshme sipas sektorëve me AKK, shoqërinë civile, komunitetin e biznesit, institucionet tjera kompetente etj.

12.Krahasimi i opsioneve

Opsioni 1: Ky opsion për mos ndryshimin e gjendjes nuk do të ketë përfitim por vetëm pasoja negative, për shkak të vështirësive në zbatim. Të gjitha institucionet shtetërore, komuna, organizatat ndërkombëtare, personat fizik dhe juridik ndikohen në rast mos ndryshimit të gjendjes përkatësisht mos stabilitet ekonomik lokal;

Opsioni 2: Me këtë opsion do të kemi një zgjidhje e cila nuk do të mund të adresoj zhvillimi e politikave të të gjitha sektorëve;

Opsioni 3: Me këtë opsion krijohet qartësi e politikave të zhvillimit ekonomik lokal e cila adreson një qëndrueshmëri në nivelin lokal dhe një rritjen e kënaqshmërisë së komunitetit të qytetarëve dhe biznesit me ofrimin e shërbimeve nga komunat;

13.Rekomandimi

14.Komunikimi

15.Anekset

16.Aneksi 1

Kategoria Ekonomike	Trendet e rritjes/ zvogëlimit 2010-2015 i shprehur në %											
	Trendet e buxhetit 2010-2015						Trendet e shpenzimeve 2010-2015					
	2011 /2010	2012 /2010	2013/2012	2014/2013	2015/2014	mesa tarja	2011 /2010	2012 /2010	2013/2012	2014/2013	2015 /2014	mesatarja
Rrogat dhe pagat	29.2	2.8	0.8	15.9	5.3	13.5	27.8	4.3	0.6	16.3	6.0	13.8
Mallrat dhe shërbimet	12.0	13.3	11.5	10.4	-8.8	9.6	10.3	17.6	4.5	-2.2	5.4	8.9
Shpenzimet komunale	-0.3	0.7	7.1	11.5	0.2	4.8	-0.6	0.8	4.6	0.7	9.0	3.6
Subvencion e dhe transfere	34.7	7.6	36.3	34.0	-18.9	23.4	31.7	8.0	32.9	28.1	-26.9	18.4

Shpenzimet kapitale(pa surit jo financ)	9.5	-0.7	4.0	-9.9	3.5	1.6	11.7	-8.5	11.1	-17.8	6.7	0.8
Gjithsej	18.7	2.3	3.8	5.8	2.4	8.3	19.4	0.9	5.1	2.9	5.1	8.4

Aneksi 2

Pasqyra e krahasimit te shpenzimeve me buxhetimin për komunit sipas kategorive ekonomike dhe sipas viteve

Kategoria Ekonomike	2010		2011		2012		2013		2014		2015		% e realizimit	mesazja e realizimit për vitet	
	Buxheti	Shpenzimet	% e realizimit	Buxheti	Shpenzimet	% e realizimit	Buxheti	Shpenzimet	% e realizimit	Buxheti	Shpenzimet	% e realizimit			
Rrogat dhe pagat	148,683,978	146,437,388	98	192,151,598	187,121,255	97	199,023,702	196,477,896	99	230,571,848	228,561,825	99	242,897,403	100	99
Mallrat dhe shërbimet	28,938,287	26,851,211	93	32,402,130	29,619,854	91	40,957,702	36,423,224	89	45,222,642	35,611,026	79	41,222,661	91	90
Shpenzimet komunale	8,583,970	8,266,448	96	8,554,537	8,215,124	96	9,227,558	8,658,737	94	10,286,254	8,723,348	85	10,306,296	92	93
Subvencionet dhe transferet	5,499,373	5,293,458	96	7,407,456	6,973,128	94	10,870,994	10,005,398	92	14,562,524	12,814,762	88	11,813,453	79	91
Shpenzimet kapitale (pa surit jo financ)	142,503,427	114,569,321	80	156,060,581	127,972,068	82	161,260,224	130,153,207	81	145,307,174	107,016,968	74	150,335,760	76	78
Gjithsej	334,209,036	301,417,826	90	396,576,303	359,901,429	91	421,340,179	381,718,462	91	445,950,442	392,727,930	88	456,575,573	90	90

Aneksi 3

Nr.	Komunat	Popullsia	Shëndetësia dhe mirëqenia sociale			
			Operative		Kapitale	
			Gjithsej	Për kokë banori	Gjithsej	Për kokë banori
1	Mitrovicë	71,909.00	2,181,891.82	30.34	29,912.80	0.42
2	Skenderaj	50,858.00	1,336,723.07	26.28	42,651.00	0.84
3	Vushtrri	69,870.00	1,648,608.14	23.60	179,480.51	2.57
4	Mitrovica e V.	12,326.00	773,941.69	62.79	54,116.47	4.39
5	Leposaviq	13,773.00	38,481.16	2.79	48,700.00	3.54
6	Zveqan	7,481.00	50,697.56	6.78	0.00	0.00
7	Zubin Potok	6,616.00	38,897.46	5.88	0.00	0.00
8	Prizren	177,781.00	3,898,474.44	21.93	408,866.06	2.30
9	Dragash	33,997.00	790,197.61	23.24	0.00	0.00
10	Malishevë	54,613.00	1,097,929.89	20.10	287,122.33	5.26
11	Mamushë	5,507	135,183.78	24.55	9,245.00	1.68
12	Rahovec	56,208	1,150,887.35	20.48	267,505.32	4.76
13	Suharekë	59,722	1,310,110.17	21.94	356,255.86	5.97
14	Gjilan	90,178	2,501,338.17	27.74	68,198.09	0.76
15	Novobërdë	6,729	221,771.36	32.96	5,000.00	0.74
16	Kamenicë	36,085	1,084,347.49	30.05	0.00	0.00
17	Ferizaj	108,610	2,679,076.66	24.67	339,655.82	3.13
18	Kaçanik	33,409	769,932.30	23.05	155,000.00	4.64
19	Shtërpcë	6,949	443,081.57	63.76	264,948.00	38.13
20	Viti	46,987	1,077,401.77	22.93	105,833.00	2.25
21	Hani i Elezit	9,403	249,150.98	26.50	6,125.00	0.65
22	Klllokot	2,556	101,776.08	39.82	0.00	0.00
23	Ranillugë	3,866	161,709.75	41.83	0.00	0.00
24	Partesh	1,787	48,566.61	27.18	0.00	0.00
25	Pejë	96,450.00	2,856,974.94	29.62	145,893.20	1.51
26	Istog	39,289.00	984,102.11	25.05	105,682.66	2.69
27	Deçan	40,019.00	1,022,393.13	25.55	0.00	0.00
28	Junik	6,084.00	179,723.52	29.54	9,989.00	1.64
29	Klinë	38,496.00	1,059,375.28	27.52	0.00	0.00
30	Gjakovë	94,556.00	2,681,523.28	28.36	99,676.50	1.05
31	Prishtinë	198,897	7,169,276.34	36.05	1,177,262.27	5.92
32	Glllogvc	58,531	1,433,741.61	24.50	95,167.00	1.63
33	Fushë Kosovë	34,827	999,287.17	28.69	267,509.39	7.68
34	Graçanicë	10,675	1,155,596.42	108.25	224,871.00	21.07
35	Lipjan	57,605	1,628,164.37	28.26	9,143.94	0.16
36	Obiliq	21,549	757,774.93	35.17	60,937.40	2.83
37	Podujevë	88,499	1,919,973.27	21.69	345,543.67	3.90
38	Shtime	27,324	643,162.28	23.54	103,824.30	3.80
	Gjithsej	1,780,021	48,281,245.53	27.12	5,274,115.59	2.96

Aneksi 4

Nr.	Komunat	Popullsia	Numri l nxenesve para fillor, fillor dhe sh. Mesme	SHPENZIMET PËR ARSIM SIPAS KOMUNAVE PËR VITIN 2015				
				Operative		Arsimi		
				Gjithsej	Për nxënë	Gjithsej	Kapitale	
1	Mitrovicë	71,909.00	17,962	7,814,354.83	435.05	46,253.00	2.58	
2	Skenderaj	50,858.00	12,520	5,293,895.01	422.84	207,013.53	16.53	
3	Vushtrri	69,870.00	16,403	7,208,716.53	439.48	526,504.26	32.10	
4	Mitrovica e V.	12,326.00	5,039	469,716.16	93.22	0.00	0.00	
5	Leposaviq	13,773.00	2,345	354,401.77	151.13	0.00	0.00	
6	Zveçan	7,481.00	1,151	275,801.24	239.62	0.00	0.00	
7	Zubin Potok	6,616.00	1,282	397,281.09	309.89	0.00	0.00	
8	Prizren	177,781.00	35,014	14,387,729.78	410.91	1,406,010.36	40.16	
9	Dragash	33,997.00	5,098	2,845,949.21	558.25	131,713.47	25.84	
10	Malishevë	54,613.00	15,719	5,982,100.40	380.56	207,757.10	13.22	
11	Mamushë	5,507	1,034	422,869.03	408.96	16,341.22	15.80	
12	Rahovec	56,208	12,604	5,285,238.09	419.33	475,888.07	37.76	
13	Suharekë	59,722	13,812	6,127,301.82	443.62	254,912.95	18.46	
14	Gjilan	90,178	21,977	12,119,379.07	551.46	258,429.10	11.76	
15	Novobërdë	6,729	1,344	982,489.06	731.02	0.00	0.00	
16	Kamenicë	36,085	6,190	4,513,953.95	729.23	0.00	0.00	
17	Ferizaj	108,610	27,436	10,848,611.37	395.42	435,775.31	15.88	
18	Kaçanik	33,409	7,109	3,595,571.59	505.78	241,767.70	34.01	
19	Shtërpçë	6,949	2,648	1,139,457.24	430.31	3,526.00	1.33	
20	Viti	46,987	10,878	4,900,304.91	450.48	40,000.00	3.68	
Aneksi 4								
21	Hani i Elezit	9,403	2,044	793,342.97	388.13	100,000.00	48.92	
22	Klllokot	2,556	659	249,052.07	377.92	0.00	0.00	
23	Ranillugë	3,866	1,346	413,483.75	307.19	9,421.00	7.00	
24	Partesh	1,787	810	369,490.72	456.16	0.00	0.00	
25	Pejë	96,450.00	20,951	9,641,314.60	460.18	869,517.88	41.50	
26	Istog	39,289.00	8,915	4,071,191.87	456.67	143,271.21	16.07	
27	Deçan	40,019.00	6,662	3,435,976.12	515.76	0.00	0.00	
28	Junik	6,084.00	927	426,547.31	460.14	0.00	0.00	
29	Klinë	38,496.00	9,155	4,055,747.70	443.01	455,005.95	49.70	
30	Gjakovë	94,556.00	20,714	9,663,037.14	466.50	234,767.52	11.33	
31	Prishtinë	198,897	48,029	21,864,906.49	455.24	2,553,255.81	53.16	
32	Gillogovc	58,531	14,003	6,056,670.01	432.53	156,377.17	11.17	
33	Fushë Kosovë	34,827	7,678	3,002,077.99	391.00	391,430.26	50.98	
34	Graçanicë	10,675	4,305	1,109,720.21	257.77	407,676.14	94.70	
35	Lipjan	57,605	14,334	6,367,053.21	444.19	267,485.34	18.66	
36	Obiliq	21,549	5,340	2,278,851.68	426.75	104,023.69	19.48	
37	Podujevë	88,499	21,373	8,787,762.54	411.16	192,627.97	9.01	
38	Shtime	27,324	6,939	2,808,725.15	404.77	120,512.35	17.37	
Gjithsej				411,749	180,360,073.68	438.03	10,257,264.36	24.91

Trendet e investimit kapitale në komuna sipas sektorëve për periudhën 2013-2015

Nr	Sektor	Viti 2013						Viti 2014						Viti 2015						
		Nr.i projekte	Buxhetimi	% pjesma rrjes me total te buxheti	Shpenzimet	% pjesmar rjes me total te shpenzi meve	% e realiz mit	Nr.i projekte	Buxhetimi	% pjesmar rjes me total te buxheti	Shpenzimet	% pjesm arjes me total te shpenz	% e realiz mit	Nr i projektev e	Buxhetimi	% pjesma rrjes me total te buxheti	Shpenzimet	% pjesma rrjes me total te shpenzi	% e realiz mit	mesatarj a e realizimit
1	Rrugë	852	52,795,131	33.3	45,887,201	34.4	86.9	696	50,317,075	35.7	39,171,993	36.2	77.9	783	55,225,553	35.3	48,240,368	41.1	87.4	84.0
2	Kanalizim	221	8,677,874	5.5	7,815,253	5.9	90.1	157	7,892,189	5.6	6,846,730	6.3	86.8	201	8,478,844	5.4	7,400,855	6.3	87.3	88.0
3	Ujësjellës	96	6,530,427	4.1	5,713,267	4.3	87.5	84	4,503,912	3.2	3,564,372	3.3	79.1	78	5,502,874	3.5	3,212,303	2.7	58.4	75.0
	Ndertimi dhe rregullimi i objekteve	85	5,695,131	3.6	4,502,549	3.4	79.1	57	4,737,799	3.4	3,525,760	3.3	74.4	85	4,219,916	2.7	2,669,820	2.3	63.3	72.2
5	Arsim	229	18,375,053	11.6	14,733,598	11.1	80.2	213	12,675,179	9.0	9,785,192	9.0	77.2	278	13,985,283	8.9	10,101,376	8.6	72.2	76.5
6	Shendetësi	124	5,276,078	3.3	3,807,608	2.9	72.2	108	5,803,043	4.1	4,608,527	4.3	79.4	103	4,940,893	3.2	4,033,344	3.4	81.6	77.7
7	Kulturë, rini dhe sport	161	6,887,705	4.3	4,518,819	3.4	65.6	130	6,728,562	4.8	4,404,535	4.1	65.5	163	6,660,290	4.3	3,606,218	3.1	54.1	61.7
8	Ambient	99	5,200,257	3.3	4,464,945	3.4	85.9	86	3,901,490	2.8	2,254,868	2.1	57.8	89	6,203,594	4.0	4,614,992	3.9	74.4	72.7
9	Sherbime publike	153	7,340,477	4.6	6,342,377	4.8	86.4	160	7,131,938	5.1	6,107,150	5.6	85.6	229	11,210,173	7.2	7,922,895	6.8	70.7	80.9
10	Infrastruktura	133	11,411,401	7.2	9,155,481	6.9	80.2	169	14,351,568	10.2	11,029,440	10.2	76.9	144	8,711,112	5.6	5,527,502	4.7	63.5	73.5
11	Bujqësi	66	1,697,244	1.1	1,531,609	1.1	90.2	88	2,428,901	1.7	1,862,121	1.7	76.7	109	3,555,667	2.3	1,942,432	1.7	54.6	73.8
12	Turizmi	8	355,326	0.2	327,334	0.2	92.1	13	323,074	0.2	203,654	0.2	63.0	15	344,769	0.2	255,356	0.2	74.1	76.4
13	Te fjera	369	28,299,998	17.9	24,475,844	18.4	86.5	400	19,978,833	14.2	14,848,148	13.7	74.3	462	27,225,747	17.4	17,823,410	15.2	65.5	75.4
14	Totali	2596	158,542,102	100.0	133,275,887	100.0	84.1	2,361	140,773,564	100.0	108,212,490	100.0	76.9	2,739	156,264,714	100.0	117,350,872	100.0	75.1	78.7

Pasqyra e projekteve te financuara nga ministririte e linjes në komuna për periudhën 2013-2015

Ministrirët	Total projektet	Totali i financimit
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	99	37,739,553
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	21	4,938,000
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor	77	13,956,308
Ministria e Shëndetsisë	12	2,359,392
Ministria për Komunitete dhe Kithim	31	7,163,632
Ministria e Financave	2	34,000
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	73	19,897,355
Ministria e Infrastrukturës	134	65,595,567
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	10	1,128,551
Ministria e Administrimit Publik	8	800,000
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	24	2,230,783
Ministria e punës dhe mirëqenia sociale	1	1,000,000
Totali	492	156,843,141

Aneksi 7

Ministritë	Pasiyra e projekteve te financuara nga ministrite e linjes në komuna për periudhën 2013-2015										Total projektet	Total i financimit					
	viti 2013					viti 2014							viti 2015				
	nr.projekt	Nr.i projekteve sipas komunave	Financimi	nr.projekt	Nr.i projekteve sipas komunave	Financimi	nr.projekt	Nr.i projekteve sipas komunave	Financimi	nr.projekt			Nr.i projekteve sipas komunave	Financimi			
Ministria e Arsimt, Shkencës dhe Teknologjisë	43	Deqan 2, Dragash 1, Ferizaj 1, Fushë Kosovë 2, Gjakovë 1, Gjiçan 2, Istog 1, Kaçanik 1, Klinë 2, Lipjan 1, Malishevë 1, Mitrovicë 4, Pejë 4, Podujevë 2, Prishtinë 2, Prizren 3, Rahovec 1, Shtime 3, Skenderaj 3, Suharekë 4, Viti 1, Vushitri 1	16,959,803	34	Deqan 2, Dragash 1, Ferizaj 1, Fushë Kosovë 1, Gjiçan 1, Glogoc 1, Istog 1, Kaçanik 1, Lipjan 2, Mitrovicë 4, Pejë 4, Podujevë 2, Prishtinë 1, Prizren 2, Rahovec 1, Shtime 1, Skenderaj 4, Suharekë 3, Viti 1	14,915,000	22	Deqan 2, Dragash 1, Ferizaj 1, Gjiçan 1, Kaçanik 1, Lipjan 1, Mitrovicë 3, Pejë 1, Podujevë 2, Prizren 2, Zvečan-Zubin Potok- Leposaviq 1	5,968,750	89	Deqan 2, Dragash 1, Ferizaj 1, Gjiçan 1, Kaçanik 1, Lipjan 1, Mitrovicë 3, Pejë 1, Podujevë 2, Prizren 2, Skenderaj 3, Suharekë 2, Viti 1, (Mitrovicë Veniore-Zvečan-Zubin Potok- Leposaviq 1)	37,739,553					
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	3	Pejë 1, Mitrovicë 1, Decan 1	960,000	6	Prishtinë 2, Decan 1, Ferizaj 1, Dragash 1, Klinë 1	800,000	12	Deqan 1, Gjiçan 1, Mitrovicë 2, Suharekë 1, Viti 1, Gjakovë 1, Obiliq 1, Prishtinë 3, (Mitrovicë Veniore-Zvečan-Zubin Potok- Leposaviq 1)	3,178,000	21	Deqan 2, Gjiçan 1, Istog 1, Mitrovicë 1, Prizren 2, Rahovec 1, Shtime 1, Skenderaj 4, Glogoc 2, Gjakov 4, Junik 1, Leposaviq 4, Zubin Potok 2, Zvečan 2, Lipjan 1, Kaçanik 2, Obiliq 1, (Mitrovicë Veniore-Zvečan-Zubin Potok-Leposaviq 1)	4,939,000					
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësror	24	Deqan 1, Ferizaj 1, Gjakovë 4, Gjiçan 1, Kaçanik 2, Lipjan 1, Mitrovicë 1, Podujevë 1, Prizren 1, Rahovec 5, Shtime 1, Skenderaj 4, Junik 1	4,580,300	20	Deqan 1, Gjiçan 1, Glogoc 3, Lipjan 1, Podujevë 1, Prizren 3, Rahovec 2, Shtime 1, Skenderaj 1, Gjakovë 2, Junik 1, Kaçanik 2, Obiliq 1	4,705,491	33	Deqan 2, Gjiçan 1, Istog 1, Mitrovicë 1, Prizren 2, Rahovec 1, Shtime 1, Skenderaj 4, Glogoc 2, Gjakov 4, Junik 1, Leposaviq 4, Zubin Potok 2, Zvečan 2, Lipjan 1, Kaçanik 2, Obiliq 1, (Mitrovicë Veniore-Zvečan-Zubin Potok-Leposaviq 1)	4,670,517	77	Deqan 2, Gjiçan 1, Istog 1, Mitrovicë 1, Prizren 2, Rahovec 1, Shtime 1, Skenderaj 4, Glogoc 2, Gjakov 4, Junik 1, Leposaviq 4, Zubin Potok 2, Zvečan 2, Lipjan 1, Kaçanik 2, Obiliq 1, (Mitrovicë Veniore-Zvečan-Zubin Potok-Leposaviq 1)	13,959,308					
Ministria e Shëndetësisë	6	Hani i Elezit 1, Klinë 1, Mitrovicë 1, Rahovec 1, Skenderaj 1, (Malishevë-Istog 1)	579,392	3	Kaçanik 1, Skenderaj 1, Mitrovicë	460,000	3	Kaçanik 1, Skenderaj 1, Mitrovicë 1	1,320,000	12	Kaçanik 1, Skenderaj 1, Mitrovicë 1	2,359,392					
Ministria për Komunitete dhe Kthim	29	Deqan 2, Ferizaj 1, Gjakovë 2, Mitrovicë 1, Prishtinë 2, Prizren 1, Skenderaj 1, Suharekë 2, Vushitri 1, Junik 1, Glogoc 1, Hani i Elezit 1, Kameric 4, Novobërd 1, Obiliq 1, Ranillug 1, Shterpe 3, Graçanicë 1, Prishtinë 1, (Suharekë-Malishevë 1)	3,362,632	1	Istog	200,000	1	(Mitrovicë Veniore-Zvečan-Zubin Potok- Leposaviq 1)	3,601,000	31	(Mitrovicë Veniore-Zvečan-Zubin Potok- Leposaviq 1)	7,163,632					
Ministria e Financave	2	Ferizaj 1, Mitrovicë 1	34,000							2		34,000					
Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	73	Deqan 5, Dragash 1, Ferizaj 5, Gjakovë 1, Gjiçan 3, Istog 5, Kaçanik 1, Klinë 2, Lipjan 1, Malishevë 1, Mitrovicë 1, Pejë 6, Podujevë 3, Prishtinë 3, Prizren 2, Rahovec 1, Shtime 7, Skenderaj 4, Suharekë 2, Viti 3, Vushitri 1, Junik 3, Mamushë 1, Glogoc 2, Hani i Elezit 2, Kameric 3, Novobërd 1, Obiliq 1, Ranillug 1, Shterpe 1	19,897,355	65	Deqan 7, Dragash 1, Ferizaj 3, Gjakovë 3, Gjiçan 2, Glogoc 2, Istog 4, Junik 2, Kamericë 2, Kaçanik 1, Klinë 4, Lipjan 1, Malishevë 1, Mamushë 1, Mitrovicë 1, Novobërdë 1, Pejë 7, Podujevë 2, Prishtinë 2, Prizren 3, Rahovec 3, Shterpe 1, Shtime 4, Skenderaj 1, Suharekë 2, Viti 1, Vushitri 1 (Glogoc-Skenderaj 1, Mitrovicë-Vushitri 1)	42,386,504	69	Deqan 3, Gjiçan 3, Istog 2, Klinë 1, Mitrovicë 1, Pejë 5, Podujevë 2, Prizren 1, Rahovec 3, Shtime 5, Skenderaj 8, Suharekë 3, Viti 1, Glogoc 2, Ferizaj 3, Gjakov 5, Junik 1, Kameric 2, Leposaviq 5, Mitrovicë V, 3, Zubin Potok 6, Zvečan 1, (Pejë- Glogoc 1, Prizren-Mamushë 1, Mitrovicë Veniore-Zvečan-Zubin Potok-Leposaviq 1)	23,209,063	134	Deqan 3, Gjiçan 3, Istog 2, Klinë 1, Mitrovicë 1, Pejë 5, Podujevë 2, Prizren 1, Rahovec 3, Shtime 5, Skenderaj 8, Suharekë 3, Viti 1, Glogoc 2, Ferizaj 3, Gjakov 5, Junik 1, Kameric 2, Leposaviq 5, Mitrovicë V, 3, Zubin Potok 6, Zvečan 1, (Pejë- Glogoc 1, Prizren-Mamushë 1, Mitrovicë Veniore-Zvečan-Zubin Potok-Leposaviq 1)	65,595,567					
Ministria e Zhvillimit Ekonomik				3	Gjiçan 1, Prishtinë 1, Pejë 1	386,091	7	Ferizaj 1, Gjiçan 1, Pejë 2, Prizren 2, (Dragash-Suharekë- Rahovec 1)	742,460	10	742,460	1,129,551					
Ministria e Administrimit Publik							8	Gjiçan 2, Glogoc 5, Graçanicë 1	800,000	8	800,000	800,000					
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal							24	Dragash 1, Ferizaj 1, Gjiçan 3, Gjakovë 2, Glogoc 1, Kaçanik 1, Lipjan 2, Mitrovicë 1, Pejë 1, Podujevë 1, Viti 1, Hani i Elezit 1, Junik 1, Kamericë 1, Obiliq 1, Prishtinë 2, Rahovec 1, Ranillug 1, (Mitrovicë Veniore-Zvečan-Zubin Potok- Leposaviq 1)	2,230,783	24	2,230,783	2,230,783					
Ministria e Punëve të Mireqenia sociale							1	(Mitrovicë Veniore-Zvečan-Zubin Potok-Leposaviq 1)	1,000,000	1	1,000,000	1,000,000					
Total	180		46,369,482	132		63,853,086	180		46,620,573	492	156,843,141						

Aneks 8


TRENDET E MBLLEDHJES SË TË HYRAVE VETANAKE DREKTE SIPAS STUKTURËS

Të hyrat vetanake	Trendet e rritjes/zvogelimit sipas viteve i shprehur ne %											
	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2010 /2011	2011 /2012	2012 /2013	2013 /2014	2014 /2015	2015 /2010
							0	1	2	3	4	5
Të hyrat nga tatimi në pronë	13,411,475	14,363,922	14,584,118	16,119,339	20,411,152	19,914,321	7.10	1.53	10.53	26.63	(2.43)	48.49
Të hyrat nga regjistrimi i automjeteve	2,261,985	2,578,033	2,503,508	2,910,060	2,916,238	3,021,391	13.97	(2.89)	16.24	0.21	3.61	33.57
Të hyrat komonale për leje ndërtimi	12,104,249	13,763,513	19,137,565	15,979,303	11,136,199	12,020,331	13.71	39.05	(16.50)	(30.31)	7.94	(0.69)
Të hyrat nga regjistrimi i Trashëgimisë	1,358,017	1,597,378	1,614,308	1,613,644	1,590,502	1,460,820	17.63	1.06	(0.04)	(1.43)	(8.15)	7.57
Të hyrat nga ndërtimi i Destinimit të tokës	1,297,966	1,071,053	2,783,952	1,584,156	2,336,036	2,022,868	(17.48)	159.93	(43.10)	47.46	(13.41)	55.85
Të Hyrat nga Dokumentet e	2,918,536	2,659,402	2,606,027	2,392,101	2,672,299	3,000,017	(8.88)	(2.01)	(8.21)	11.71	12.26	2.79


Gjendjes
Civile

Të hyrat nga veprimtaritë afariste	3,681,043	3,777,437	3,103,379	1,729,336	1,592,462	1,481,562	2.62	(17.84)	(44.28)	(7.91)	(6.96)	(59.75)	(12.40)
Të hyrat nga shfrytëzimi I pronës publike	2,287,468	2,883,513	2,222,475	2,593,554	2,935,795	2,625,012	23.87	(21.56)	16.70	13.20	(10.59)	14.76	3.60
Të hyrat nga participimet në Arsime dhe Shendetësi	3,644,993	4,007,221	4,117,668	4,162,199	4,198,955	4,033,546	9.94	2.76	1.08	0.88	(3.94)	10.66	1.79
Të hyrat e tjera	3,175,023	3,114,980	3,146,658	3,088,709	2,662,902	3,705,428	(1.89)	1.02	(1.84)	(13.79)	39.15	16.71	3.77
Totali	46,140,754	49,766,453	55,819,659	52,172,402	52,452,540	53,285,296	7.86	12.16	(6.53)	0.54	1.59	15.48	2.60

Aneksi 9



Aneksi 10



Анекси 11

